



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPSTINA GRAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odhëgjatë 24 Opstë Upravu

III. Nr. i prot. 06 Më 03.04.25
Dr. prot. Dr. RAHOVEC - GRAHOVAC

RAPORT VJETOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

JANAR – DHJETOR 2024

KOMUNA E RAHOVECIT

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	2
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA	4
SFIDA DHE REKOMANDIME	4
STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE	5
SHTOJCË- INDIKATORËT E PERFORMANCËS;.....	6
PËRFUNDIM	7

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit ka realizuar një gamë të gjerë aktivitetesh inspektuese dhe mbikëqyrëse, duke siguruar zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe pronës publike. Aktivitetet janë përqendruar në sektorët e ndërtimit, mjedisit, tregut, transportit publik, dhe çështjeve komunale, si dhe kanë përfshirë bashkëpunimin me autoritetet përkatëse për të adresuar sfidat dhe për të siguruar përmbushjen e normave ligjore.

Në total, janë realizuar 670 inspektime dhe janë shqiptuar 186 gjopa për shkelje të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera, si Policia e Kosovës, Gjykatat dhe organet e tjera të administratës, ka qenë i rëndësishëm për përmbushjen e detyrave të drejtorisë dhe mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Sektori i Ndërtimit

Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektorët përkatës, janë inspektuar dhe ri-inspektuar 80 objekte ndërtimore të kategorisë së parë, poashtu është bërë inspektimi i dokumentacionit teknik (projekti i ndërtimit, lejet e ndërtimit, janë shqiptuar 109 gjopa mandatore për ndërtim pa leje, si dhe janë obliguar që të pajisen me leje ndërtimore, ku prej tyre : 62 janë pajisur me leje ndërtimore, 9 janë në proces , 48 tjerë janë pajisur me kushte ndërtimore, 11 kërkesa janë në shqyrtim dhe 11 janë refuzuar;

Poashtu, në sektorin e ndërtimit është bërë përpilimi i procesverbaleve për gjendjen e punimeve në vend ndërtim, për respektimin ose mosrespektimin e kushteve të përcaktuara për ndërtim, dhënia e vendimit për ndërprerjen e punimeve ndërtimore deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedural si dhe janë marrë vendime për ndërprerjen (pezullimin) e punimeve, deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedurale;

Sektori i Mjedisit

Në sektorin e mjedisit, gjatë periudhës raportuese janë kryer 93 inspektime. Inspektimet kanë përfshirë kontrollin dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, janë shqiptuar 52 gjopa mandatore për ndotje të mjedisit.

Poashtu, janë inspektuar 30 biznese që ushtrojnë aktivitete të dëmshme për mjedisin, duke kërkuar pajisjen e tyre me leje mjedisore dhe duke siguruar që ato të veprojnë në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e natyrës. 24 prej tyre kanë aplikuar për leje mjedisore në DUPMM, 21 janë pajisur me leje mjedisore 3 janë refuzuar si dhe 6 janë gjobitur për mos dëshmi të lejes mjedisore komunale.

Sektori i Cështjeve Komunale

Në këtë sektor, Drejtoria për Punë Inspektuese ka trajtuar një numër të madh kërkesash nga qytetarët, kryesisht në lidhje me problemet në rrjetin e kanalizimit dhe çështje të ndryshme infrastrukturore. Inspektorët kanë reaguar ndaj kërkesave dhe kanë ndërmarrë veprime për zgjidhjen e problemeve të shfaqura, duke siguruar që infrastrukturën komunale të jetë në përputhje me standardet dhe të shërbejë interesave të qytetarëve. Përveç trajtimit të kërkesave të qytetarëve, janë shqiptuar 41 gjopa dhe janë marrë masa kundër shkeljeve të rregullave të përbashkëta për përdorimin e hapësirave publike. Janë lëshuar 41 aktvendime kundrejt KRU GJAKOVA, për të siguruar që të gjitha aktivitete të zhvillohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

Poashtu 90 shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste u janë shpërndarë urdhëresa për tu pajisur me lejet përktëse për shfrytëzim të hapësirave publike, përkitazi me rregulloren komunale, 81 prej tyre janë pajisur me leje nga DSHP dhe 7 janë refuzuar.

Në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së pronës publike është bërë rrënimi i tre mureve në qytetin e Rahovecit, një shtëpie në qytetin e Rahovecit, janë rrënuar edhe dy objekte në fshatin Xërxë, si dhe janë rrënuar dy objekte në fshatin Krushë e Madhe që të gjitha këto hapësira publike tashmë të lira për shfrytëzim nga qytetarët;

Sektori i Tregut

Gjatë vitit 2024, sektori i tregut ka mbikëqyrur dhe kontrolluar bizneset dhe tregtarët për të siguruar që ato të ofrojnë produkte të sigurta dhe të respektojnë normat për çmimet dhe etiketimin. Gjatë periudhës, janë realizuar inspektime në dyqane dhe markete, dhe janë shqiptuar 8 gjopa mandatore për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje çmimesh.

Përveç kësaj, janë verifikuar peshoret në tregjet e bukës për të siguruar që ato të jenë të sakta dhe të përmbushin kërkesat teknike, për të parandaluar mashtrimet dhe për të mbrojtur konsumatorët. Ky sektor ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe në luftën kundër ekonomisë informale, Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 70 është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë; 70 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;

Sektori i Transportit Publik dhe Komunikacionit

Në sektorin e transportit publik, Drejtoria për Punë Inspektuese ka mbikëqyrur kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve dhe ka siguruar që ato të përmbushin kërkesat e

rendit dhe sigurisë. Inspektorët kanë monitoruar linjat e autobusëve dhe kanë urdhëruar autotaksitë për vazhdimin e lejeve për transportin e udhëtarëve. Ky sektor ka siguruar që qytetarët të kenë mundësi për transport të sigurt dhe të rregullt, në përputhje me ligjin.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Drejtoria për Punë Inspektuese ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, Gjykatat dhe organet tjera të administratës për të siguruar zbatimin e ligjit dhe rregullave në fushat përkatëse. Në veçanti, janë ndërmarrë veprime për të zgjidhur çështje ligjore dhe për të siguruar që të gjitha shkeljet e ligjit të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë. Gjithashtu, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ka qenë esencial për zbatimin e masave ndaj subjekteve të dyshuara për aktivitet të paligjshëm, ndërsa me gjykatat janë realizuar veprime për ndjekjen e rasteve të ndërtimit pa leje dhe shkeljeve të tjera të ligjit.

SFIDA DHE REKOMANDIME

Sfida:

- Mungesa e bashkëpunimit të disa bizneseve dhe qytetarëve për t'u pajisur me dokumentet e nevojshme;
- Ndërtimi pa leje dhe mungesa e respektimit të kushteve të ndërtimit.

Rekomandime:

- Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional për një zbatim më efikas të ligjit;
- Edukimi i qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e përmbushjes së kushteve ligjore;
- Angazhimi i inspektorëve dhe rritja e kapaciteteve për të monitoruar dhe zgjidhur problemet infrastrukturore;
- Përdorimi i teknologjive moderne për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit.

STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	109	41,800.00€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE	41	6395€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	10	500 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	52	4000€
<u>TOTALI:</u>	212	52,695.00€

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	37	370 €
PËLQIME PUNE	70	1050 €
<u>TOTALI:</u>	107	1420€

<u>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI:</u>	<u>JANAR – DHJETOR 2024</u>	<u>54.115.00€</u>
--	------------------------------------	--------------------------

SHTOJCË- INDIKATORËT E PERFORMANCËS;

FUSHA 7: PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL

Komuna	Rahovec
Referenca	7.2.2
Fusha	PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL
Rezultati	Ndërtim i planifikuar komunal
Emri i treguesit	Ndërtesa të reja të inspektuara

- Numri i përgjithshëm i objekteve të reja të inspektuara gjatë vitit të raportimit – 80;
- Numri i objekteve të reja me leje të ndërtimit nga objektet e inspektuara – 62.

FUSHA 15: MBROJTJA E MJEDISIT

Komuna	Rahovec
Referenca	12.1.3
Fusha	MBROJTJA E MJEDISIT
Rezultati	Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm
Emri i treguesit	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale

- Numri i objekteve të reja për të cilat kërkohet leje mjedisore të inspektuara gjatë vitit të raportimit – 30;
- Numri i gjobave të shqiptuara për mos posedimin dhe zbatimin e LMK – 6;
- Numri i fletëparaqitjeve në gjykatë për mos posedimin dhe zbatimin e LMK – 8.

PËRFUNDIM

Përkundër të gjitha sfidave, konsiderojmë që jemi në rrugë të mirë për përmbushjen e të gjitha objektivave, sigurisht edhe me një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat po na ndihmojnë me arritjen e rezultateve konkrete.

Nora BOSHNIJAKU

Drejtoreshë për Punë Inspektuese



RAPORT VIETOR, PUNES DREJTORIA PER PUNE INSPEKTUESE